

Projekti

“Forcimi i Privatësisë dhe Sigurisë së të dhënave për Grupet Vulnerabël në Tiranë”

Organizata Zbatuese: Instituti Liberal i Tiranës Pashko

Qëllimi i përgjithshëm: Ky projekt ka si qëllim kryesor të forcojë mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave personale për grupet vulnerabël në Tiranë, duke rritur ndërgjegjësimin, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të menaxhuar dhe mbrojtur informacionet sensitive. *Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një kulture të sigurisë së të dhënave, të përputhur me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, duke reduktuar rrezikun e abuzimit dhe keqpërdorimit të të dhënave personale në komunitete të marginalizuara.*

Përshkrimi i aktivitetit:

Ky aktivitet përfshin organizimin e 5 trajnimeve praktike për 100 qytetarë nga grupet vulnerabël në Tiranë. Trajnimet do të zhvillohen në grupe të vogla (nga 15-20 pjesëmarrës) për të siguruar një qasje interaktive dhe individuale. Çdo sesion trajnim do të zgjasë 3-4 orë dhe do të përfshijë prezantime, diskutime, dhe aktivitete praktike. Trajnerët do të jenë ekspertë në fushën e sigurisë së të dhënave dhe do të përdorin materiale didaktike si prezantime vizuale, skenarë, dhe raste studimi për të ilustruar konceptet e rëndësishme. Rritja e kapaciteteve të qytetarëve për të menaxhuar të dhënat e tyre personale është një hap i rëndësishëm për të forcuar mbrojtjen e privatësisë. Këto trajnime do të ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së informacionit personal dhe t'i pajisin ata me teknikat dhe mjetet e nevojshme për të vepruar në situata të ndryshme.

Objektivi specifik i aktivitetit:

O.S.1. Rritja e kapaciteteve të 100 qytetarëve në Tiranë nga grupet vulnerabël përmes trajnimeve praktike mbi standardet dhe praktikat më të mira të sigurisë së të dhënave, duke i fuqizuar ata për të mbrojtur dhe menaxhuar në mënyrë të sigurt të dhënat e tyre personale.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit:

Eksperti me mbështetjen e organizatës do të ketë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitja e modulit të trajnimit
- Mbajtjen e kontakteve dhe koordinimin me stafin implementues të projektit
- Një kuptim i thellë i sigurisë së të dhënave online dhe mbrojtjes së tyre
- Ekspertizë në metodologjitë edukative dhe hartimin mësimor;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, aftësi për të përcjellë koncepte komplekse mbi sigurinë e të dhënave në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për target grupin
- Përgatitjen e prezantimit dhe materialeve trajnimi;
- Hartimi i një raporti në përfundim të aktivitetit

Kriteret për aplikim

- Një diplomë akademike në fushën e IT, sigurisë kibernetike apo fusha të ngjashme.
- Eksperienca të mëparshme në mbajtjen e trajnimeve të ngjashme
- Eksperienca në sektorin e shoqërisë civile

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Jetëshkrim (CV)
- Ofertën Financiare

Procedura e Vlerësimit

Zgjedhja e personit do të bazohet në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit:	Vlerat në %
Kualifikime	30 %
Eksperienca Pune	40 %
Oferta Financiare	30 %

Individët e interesuar duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës 13 Maj 2025, në adresën elektronike: info@ilp-al.org dhe cc gentjan.hajdari@ilp-al.org.

**Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët fitues do të kontaktohen.*